



**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE
TË SHOQËRISË “UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË” SHA
AKSIONARI I VETËM BASHKIA TIRANË**

V E N D I M

Nr. 06, datë 16.10.2020

P Ë R

**“LIRIMIN NGA DETYRA TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHOQËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A DHE ZËVENDËSIMIN E TIJ”**

Në mbështetje të neneve 135, pika 2, gërma c dhe 158 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”; statutit të UKT sh.a, nenet 7 dhe 18, Asambleja e Aksionarëve e Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a,

V E N D O S I:

1. Lirimin nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a të Z.Redi Molla;
2. Emërimin në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a të Z.Elton Kacidhja;
3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a me zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

K R Y E T A R I

ERION VELIAJ



**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE
TË SHOQËRISË “UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË” SH.A
AKSIONARI I VETËM BASHKIA TIRANË**

V E N D I M

Nr. 05, datë 16 . 10 . 2020

PËR

**“LIRIMIN, MANDATIMIN DHE RIMANDATIMIN E KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË
SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A”**

Në mbështetje të nenit 135, pika 2, gërma c dhe nenit 154 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”; statutit të shoqërisë, nenet 11 dhe 12, shkresës nr.14578 prot, datë 11.09.2020, Asambleja e Aksionarëve e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a,

V E N D O S I :

1. Përfundimin e mandatit 3 vjeçar të anëtarëve të Këshillit të Administrimit të Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Rimandatimin në Këshillin e Administrimit të Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a, të :
 - Z.Taulant Tusha Kryetar/Përfaqësues i Bashkisë Tiranë
 - Z.Alban Dokushi Zv.Kryetar/Përfaqësues i Bashkisë Tiranë
3. Lirimin nga detyra e anëtarit të Këshillit të Administrimit të UKT sh.a, të:
 - Z.Redi Molla Anëtar/Drejtor i Përgjithshëm
4. Mandatimin, si anëtar të Këshillit të Administrimit të Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a, të:
 - Z.Elton Kacidhja Anëtar/Drejtor i Përgjithshëm
5. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a me zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

K R Y E T A R I

ERION VELIAJ